

31973L0239

Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës

Gazeta Zyrtare L 228, 16/08/1973 f. 0003-0019

Botim i posaçëm në gjuhën finlandeze: Kapitulli 6 Vëllimi 1 f. 0146

Botimi i posaçëm në gjuhën greke: Kapitulli 6 Vëllimi 1 f. 0157

Botimi i posaçëm në gjuhën suedeze: Kapitulli 6 Vëllimi 1 f. 0146

Botimi i posaçëm në gjuhën spanjolle: Kapitulli 06 Vëllimi 1 f. 0143

Botimi i posaçëm në gjuhën portugeze: Kapitulli 06 Vëllimi 1 f. 0143

DIREKTIVA E PARË E KËSHILLIT, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (73/239/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Europian, në veçanti Nenin 57, paragrafi 2, të tij;

Duke pasur parasysh Programin e Përgjithshëm (1) për heqjen e kufizimeve mbi lirinë e vendosjes dhe në veçanti Titullin IV C të tij;

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit;

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Europian (2);

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (3);

Meqë, me anë të Programit të Përgjithshëm heqja e kufizimeve mbi vendosjen e agjencive dhe degëve në rastin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve të drejtpërdrejta varet nga bashkërendimi i kushteve për fillimin dhe ndjekjen e kësaj veprimtarie tregtare; meqë është mirë që një bashkërendim i tillë të bëhet në radhë të parë në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës;

Meqë, për të mundësuar fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit, është thelbësore të eliminohen disa divergjenca që ekzistojnë ndërmjet legjislacioneve kombëtare të mbikëqyrjes; meqë për arritjen e këtij objekti dhe, në të njëjtën kohë, për sigurimin e mbrojtjes adekuate të palëve të siguruara dhe palëve të treta në të gjitha Shtetet Anëtare, është e dëshirueshme të bashkërendohen dispozitat në lidhje me garancitë financiare që u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve;

Meqë duhet një klasifikim i risqeve në klasat e ndryshme të sigurimeve, për të përcaktuar, në veçanti, veprimtaritë objekt i autorizimit të detyrueshëm dhe sasinë e fondit minimal të garancisë për klasën e sigurimeve në fjalë;

Meqë është e dëshirueshme që nga fusha e zbatimit të kësaj Direktive të përjashtohen disa fonde kolektive të cilat, për shkak të statusit ligjor, përmbushin kriteret në lidhje me garancitë dhe me dorëzantë e tjera specifike financiare; meqë është po ashtu e dëshirueshme të përjashtohen disa institucione të caktuara në disa Shtete Anëtare veprimtaria e të cilave mbulon vetëm një sektor shumë të kufizuar dhe me ligj nuk lejohet të dalë jashtë një territori të përcaktuar apo jashtë disa personave të përcaktuar;

Meqë në ligje të ndryshme ka rregulla të ndryshme lidhur me ndërmarrjen e njëkohshme të sigurimit shëndetësor, sigurimit të kredisë dhe dorëzantisë dhe sigurimit në lidhje me veprimet ligjore kundër të tretëve dhe në lidhje me mbrojtjen ligjore, qoftë me njëra tjetrën ose paralelisht me klasa të tjera të sigurimeve; meqë vijimi i kësaj divergjence pas heqjes së kufizimeve mbi të drejtën e vendosjes në klasat e sigurimeve pa përfshirë sigurimin e jetës do të thoshte se do të vijonin të ekzistonin pengesat ndaj vendosjes; meqë duhet siguruar një zgjidhje e këtij problemi në bashkërendimin e mëpasshëm që do të kryhet brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore;

Meqë është e nevojshme të shtrihet mbikëqyrja në çdo Shtet Anëtar për të mbuluar të gjitha klasat e sigurimeve për të cilat zbatohet kjo Direktivë; meqë një mbikëqyrje e tillë nuk është e mundshme nëse ndërmarrja e klasave të tilla të sigurimeve nuk është objekt i një autorizimi zyrtar; meqë, për rrjedhojë, është e nevojshme të përcaktohen kushtet për dhënien ose heqjen e një autorizimi të tillë; meqë duhet parashikuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës në rast refuzimi apo heqjeje të një autorizimi të tillë;

Meqë është e dëshirueshme të vendosen rregulla më të lirshme mbi ato klasa të sigurimeve që njihen si klasat e sigurimit të transportit, që mbajnë numrin 4, 5, 6, 7 dhe 12 në Pikën A të Shtojcës, duke pasur parasysh luhatjet e vazhdueshme të kushteve që prekin mallrat dhe kreditimin;

Meqë kërkimi i një mënyre të përbashkët të llogaritjes së rezervave teknike është, hë për hë, objekt i studimeve në nivel të Komunitetit; meqë, për rrjedhojë, duket se është e dëshirueshme të rezervohet për direktivat e mëpasshme arritja e bashkërendimit në këtë çështje, si edhe çështjet e lidhura me përcaktimin e kategorive të investimeve dhe vlerësimin e aktiveve; (1) GZ Nr. 2, 15.1.1962, f. 36/62. (2) GZ Nr. C 27, 28.3.1968, f. 15. (3) GZ Nr. 158, 18.7.1967, f. 1.

Meqë është e nevojshme që, mbi nivelin e rezervave teknike me vlerë të mjaftueshme për të shlyer përgjegjësitë e kontraktuara, ndërmarrjet e sigurimeve të kenë një rezervë shtesë, e njohur si niveli i aftësisë paguese, që përbëhet nga aktive të lira, i cili të veprojë si mbrojtje nga luhatjet e veprimtarisë tregtare; meqë për të siguruar që kërkesat e vendosura me këtë qëllim janë përcaktuar sipas kriterëve objektive sipas të cilave ndërmarrjet me madhësi të njëjtë vendosen në të njëjtat kushte sa i takon konkurrencës, është e dëshirueshme të parashikohet që ky nivel të lidhet me të gjithë vëllimin e veprimtarisë tregtare të ndërmarrjes dhe të përcaktohet duke u mbështetur në dy tregues sigurie, ku njëri mbështetet tek primet, ndërsa tjetri tek kërkesat për dëmshpërblim;

Meqë është e dëshirueshme të kërkohet një fond minimal i lidhur me madhësinë e riskut në klasat e ndërmarrja, për të siguruar që ndërmarrjet të zotërojnë burime të mjaftueshme në momentin e themelimit dhe që në rrjedhën e mëpasshme të veprimtarisë tregtare niveli i aftësisë paguese të mos bjerë në asnjë rast nën minimumin e sigurisë;

Meqë është e nevojshme të parashikohen masa në rastet kur gjendja financiare e ndërmarrjes bëhet e tillë që e bën të vështirë përmbushjen e përgjegjësive të kontraktuara;

Meqë rregullat e bashkërenduara në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimeve të drejtpërdrejta brenda Komunitetit është mirë që, në parim, të zbatohen për të gjitha ndërmarrjet që hyjnë në treg dhe, rrjedhimisht, edhe për agjencitë dhe degët në rastet kur zyra qendrore e ndërmarrjes ndodhet jashtë Komunitetit; meqë, sidoqoftë, është e dëshirueshme që sa u takon mënyrave të mbikëqyrjes të parashikohen dispozita të posaçme për këto agjenci dhe degë, duke mbajtur parasysh faktin se aktivet e ndërmarrjeve të cilave u përkasin ndodhen jashtë Komunitetit;

Por meqë është e dëshirueshme të lejohet lehtësimi i kushteve të tilla të posaçme, duke respektuar në të njëjtën kohë parimin që agjenci dhe degë të tilla të mos përfitojnë trajtim më favorizues se ndërmarrjet brenda Komunitetit;

Meqë janë të nevojshme disa dispozita të caktuara kalimtare në mënyrë që, në veçanti, t'u jepet mundësi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ekzistojnë prej më parë të përshtaten me kërkesat që duhet të vendosin Shtetet Anëtare në zbatim të kësaj Direktive, në varësi të zbatimit të nenit 53 të Traktatit;

Meqë është e rëndësishme të garantohet zbatim i njëtrajtshëm i rregullave të bashkërenduara dhe të parashikohet, në këtë aspekt, një bashkëpunim i ngushtë në këtë fushë ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare;

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Titulli I - Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Kjo Direktivë ka të bëjë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së vetë-punësuar të sigurimeve të drejtpërdrejta të ushtruara nga ndërmarrjet e vendosura në një Shtet Anëtar ose që dëshirojnë të vendosen në një Shtet Anëtar, në klasat e sigurimeve të përcaktuara në Shtojcën e kësaj Direktive.

Neni 2

Kjo direktivë nuk zbatohet për: 1. Llojet e mëposhtme të sigurimeve: (a) sigurimi i jetës, që është dega e sigurimeve që përfshin në veçanti sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar, sigurimin për vdekjen, sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme, sigurimin e jetës me kthim të primeve, sigurimin e martesës dhe sigurimin e lindjes;

(b) anuitetet;

(c) sigurimet shitesë të ofruara nga ndërmarrjet e sigurimit të jetës, që janë në veçanti sigurimi ndaj dëmtimit personal duke përfshirë paaftësinë për punë, sigurimin për vdekjen e shkaktuar nga aksidenti dhe sigurimin për invaliditetin e shkaktuar nga aksidenti ose sëmundja, kur këto lloje të ndryshme risqesh merren në sigurim si shitesë ndaj sigurimit të jetës;

(d) sigurimet që janë pjesë e një sistemi ligjor të sigurimeve shoqërore;

(e) lloji i sigurimit që ekziston në Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, i cili njihet si “sigurim i përhershëm i shëndetit që nuk mund të anulohet”.

2. Operacionet e mëposhtme: (a) operacionet e kthimit të kapitalit, siç përkufizohen në legjislacionin e çdo Shteti Anëtar;

(b) operacionet e institucioneve të providencës dhe të përfitimit kolektiv pagesat e të cilave ndryshojnë sipas burimeve të disponueshme dhe në të cilat kontributet e anëtarëve përcaktohen me bazë të sheshtë;

(c) operacionet e kryera nga organizata pa personalitet juridik me qëllim që të sigurojnë mbulim kolektiv të anëtarëve të tyre pa pagesë primi ose pa krijim rezervash teknike;

(d) në pritje të bashkërendimit të ardhshëm, i cili do të zbatohet brenda katër vjetësh pas komunikimit të kësaj Direktive, operacionet e sigurimit të kreditimit të eksporteve për llogari të Shtetit ose me mbështetjen e Shtetit.

Neni 3

1. Kjo Direktivë nuk zbatohet për fondet kolektive për aq sa këto përmbushin kushtet e mëposhtme: - statuti duhet të përmbajë dispozita për kërkimin e kontributeve të tjera shtesë, ose për zvogëlimin e pagesave,

- veprimtaria tregtare e tyre nuk i mbulon risqet e përgjegjësisë së kontraktuar (me përjashtim të rastit kur kjo përbën mbulim shtesë sipas kuptimit të shkronjës “c” të Shtojcës) apo risqet e kreditit dhe të dorëzarisë,

- të ardhurat vjetore si kontribut për veprimtaritë që mbulon kjo Direktivë nuk duhet të jenë më shumë se një milion njësi llogarie,

dhe

- të paktën një e dyta e të ardhurave si kontribut nga veprimtaritë që mbulon kjo Direktivë duhet të vijnë nga persona që janë pjesëmarrës në fondin kolektiv.

2. Kjo Direktivë nuk zbatohet as për fondet kolektive që kanë lidhur me fonde të tjera të kësaj natyre një marrëveshje që parashikon risigurimin e plotë të policave të sigurimit të lëshuara prej tyre ose në bazë të të cilave ndërmarrja koncesionare duhet të përmbushë detyrimet e kontraktuara që lindin në kuadër të policave të tilla në vend të ndërmarrjes ceduese.

Në një rast të tillë ndërmarrja koncesionare është objekt i rregullave të kësaj Direktive.

Neni 4

Kjo Direktivë nuk zbatohet për institucionet e mëposhtme nëse nuk ndryshohet në lidhje me kapacitetin statuti i tyre ose ligji: (a) në Gjermani

- Institucionet e mëposhtme të së drejtës publike që gëzojnë monopol (Monopolanstalten):
1. Badische Gebäudeversicherungsanstalt, Karlsruhe,
 2. Bayerische Landesbrandversicherungsanstalt, Mynih,
 3. Bayerische Landestiersversicherungsanstalt, Schlachtviehversicherung, Mynih,
 4. Braunschweigische Landesbrandversicherungsanstalt, Brunsvik,
 5. Hamburger Feuerkasse, Hamburg,
 6. Hessische Brandversicherungsanstalt (Hessische Brandversicherungskammer), Darmshtad,
 7. Hessische Brandversicherungsanstalt, Kasel,
 8. Hohenzollernsche Feuerversicherungsanstalt, Zigmaringen,
 9. Lippische Landesbrandversicherungsanstalt, Detmold,
 10. Nassauische Brandversicherungsanstalt, Visbaden,
 11. Oldenburgische Landesbrandkasse, Oldenburg,
 12. Ostfriesische Landschaftliche Brandkasse, Aurih,
 13. Feuersozietät Berlin, Berlin,
 14. Württembergische Gebäudebrandversicherungsanstalt, Shtuttgart.

Megjithatë, kapaciteti territorial nuk konsiderohet si i modifikuar në rastin e një bashkimi ndërmjet institucioneve të tilla i cili ka për efekt ruajtjen për llogari të institucionit të ri kapacitetin territorial të institucioneve të bashkuara, dhe as kapaciteti lidhur me klasat e sigurimeve nuk do të konsiderohet si i modifikuar nëse njëri prej këtyre institucioneve merr përsipër në lidhje me të njëjtin territor një ose më shumë prej klasave të një tjetër institucioni të tillë.

- Institucionet e mëposhtme gjysmëpublike:
1. Postbeamtenkrankenkasse,
 2. Krankenversorgung der Bundesbahnbeamten;

(b) në Francë

- Institucionet e mëposhtme:
1. Caisse départementale des incendiés des Ardennes,
 2. Caisse départementale des incendiés de la Côte-d'Or,
 3. Caisse départementale des incendiés de la Marne,
 4. Caisse départementale des incendiés de la Meuse,

5. Caisse départementale des incendiés de la Somme,

6. Caisse départementale grêle du Gers,

7. Caisse départementale grêle de l'Hérault;

(c) në Irlandë

Voluntary Health Insurance Board;

(d) në Itali,

The Cassa di Previdenza per l'assicurazione degli sportivi (Sportass);

(e) në Mbretërinë e Bashkuar

The Crown Agents.

Neni 5

Në kuptim të kësaj Direktive: (a) “njësia e llogaritjes” është njësia e përkufizuar në nenin 4 të Statutit të Bankës Europiane të Investimeve;

(b) “aktivet e përputhura” janë paraqitja e përgjegjësive të kontraktuara të shprehura në një monedhë të caktuar përmes aktiveve të shprehura ose konvertueshme në të njëjtën monedhë;

(c) “vendndodhja e aktiveve” është ekzistenca e aktiveve, të luajtshme ose të paluajtshme, brenda një Shteti Anëtar por kjo nuk interpretohet si një kërkesë që aktivet e luajtshme të depozitohen apo që aktivet e paluajtshme t'u nënshtrohen masave kufizuese siç është regjistrimi i barrës hipotekare. Aktivet e paraqitura si pretendime kundrejt debitorëve konsiderohen se ndodhen në Shtetin Anëtar ku duhen likuiduar.

Titulli II – Rregullat e zbatueshme për ndërmarrjet me zyra qendrore brenda Komunitetit

Seksioni A : Kushtet e pranimit

Neni 6

1. Çdo Shtet Anëtar e kushtëzon me një autorizim zyrtar fillimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve të drejtpërdrejta në territorin e tij.

2. Këtë autorizim mund ta kërkojë pranë autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar në fjalë: (a) çdo ndërmarrje që e ka vendosur zyrën qendrore në territorin e Shtetit në fjalë;

(b) çdo ndërmarrje që e ka zyrën qendrore në një Shtet Anëtar tjetër dhe që hap një degë ose agjenci në territorin e Shtetit Anëtar në fjalë;

(c) çdo ndërmarrje që, pasi ka marrë autorizimin e përmendur në shkronjën “a” ose “b” më lart, e shtrin veprimtarinë tregtare në territorin e një Shteti të tillë ose në klasa të tjera;

(d) çdo ndërmarrje që, pasi ka marrë në përputhje me nenin 7 pika 1 një autorizim për një pjesë të territorin kombëtar, e shtrin veprimtarinë e vet tregtare përtej një pjese të tillë.

3. Shtetet Anëtare nuk e kushtëzojnë një autorizim të tillë me bërjen e një depozite ose me dhënien e një garancie.

Neni 7

1. Autorizimi është i vlefshëm për të gjithë territorin kombëtar me përjashtim të rastit kur, për aq sa e lejon legjislacioni kombëtar, subjekti kërkon leje për ta ushtruar veprimtarinë tregtare vetëm në një pjesë të territorit kombëtar.

2. Autorizimi jepet për një klasë të caktuar sigurimesh. Autorizimi mbulon të gjithë klasën, nëse ndërmarrja e interesuar nuk dëshiron të mbulojë vetëm disa prej risqeve që i përkasin klasës në fjalë, sipas renditjes në pikën "A" të Shtojcës.

Por: (a) Do të jetë e hapur për çdo Shtet Anëtar dhënia e një autorizimi për çdo grup klasash të përmendura në pikën "B" të Shtojcës, me kusht që këtij autorizimi t'i vendosë emërtimin e duhur të përcaktuar në të;

(b) Autorizimi i dhënë për një klasë ose grupim klasash është i vlefshëm edhe për të mbuluar risqet shtesë të përfshira në një klasë tjetër nëse përmbushen kushtet e vendosura në pikën "C" të Shtojcës;

(c) Në pritje të bashkëndimit të ardhshëm, i cili duhet vënë në zbatim brenda katër vjetësh pas komunikimit të kësaj Direktive, Republika Federale e Gjermanisë mund ta mbajë në fuqi ndalimin e ndërmarrjes së njëkohshme të sigurimit shëndetësor, sigurimit të kreditit dhe të dorëzansisë ose sigurimet në lidhje me paditë kundër të tretëve dhe në lidhje me mbrojtjen ligjore, ose mes njëra tjetrës ose me klasa të tjera.

Neni 8

1. Çdo Shtet Anëtar kërkon që çdo ndërmarrje e ngritur në territorin e tij për të cilën kërkohet autorizim: (a) duhet të jetë në njërin nga format e mëposhtme: - në rastin e Mbretërisë së Belgjikës:

"société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/vennootschap bij wijze van geldschieting op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringmaatschappij", "société coopérative/cooperative vennootschap",

- në rastin e Danimarkës:

"Aktieselskaber" (shoqëritë aksionare), "gensidige selskaber" (fondet kolektive),

- në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë:

"Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "Öffentlich-rechtliches Wettbewerbs-Versicherungsunternehmen",

- në rastin e Republikës Franceze:

"société anonyme", "société à forme mutuelle", "mutuelle", "union de mutuelles",

- në rastin e Republikës së Irlandës:

"incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited",

- në rastin e Republikës Italiane:

"società per azioni", "società cooperativa", "mutua di assicurazione",

- në rastin e Dukatit të Madh të Luksemburgut:

"société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative",

- në rastin e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta:

"naamloze vennootschap", "onderlinge waarborgmaatschappij", "coöperative vereniging",

- në rastin e Mbretërisë së Bashkuar:

"incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies registered under the Friendly Societies Act" Lloyd's underwriters.

Gjithashtu, sipas rastit, Shtetet Anëtare mund të ngrenë ndërmarrje në çdo formë të parashikuar nga e drejta publike, me kusht që këto institucione të kenë si objekt të veprimtarisë operacionet e sigurimeve sipas kushteve të barasvlershme me ato që zbatohen për ndërmarrjet e së drejtës private;

(b) duhet të përfshijë në objektin e vet vetëm veprimtarinë tregtare të sigurimeve dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt prej sigurimeve, duke mos përfshirë asnjë veprimtari tjetër tregtare;

(c) duhet të paraqesë skemën e operacioneve në përputhje me dispozitat e nenit 9;

(d) duhet të ketë fondin minimal të garancisë të parashikuar në nenin 17 pika 2.

2. Ndërmarrjes që kërkon autorizim për ta zgjeruar veprimtarinë tregtare në klasa të tjera apo, në rastin e përmendur në nenin 6 pika 2 shkronja "d", në një pjesë tjetër të territorit i kërkohet të paraqesë skemën e operacioneve në përputhje me dispozitat e nenit 9 në lidhje me këto klasa të tjera apo me këtë pjesë tjetër të territorit.

Gjithashtu, i kërkohet të paraqesë vërtetim se zotëron nivelin e aftësisë paguese të parashikuar në nenin 16 dhe, nëse në lidhje me klasat e tjera në fjalë dispozitat e nenit 17 pika 2 kërkojnë një fond minimal garancie më të lartë se më parë, i kërkohet të paraqesë vërtetim se e zotëron këtë minimum.

3. Këto masa bashkërenduese nuk i pengojnë Shtetet Anëtare të zbatojnë dispozita që u kërkojnë anëtarëve të këshillit të administrimit dhe administratorëve të kenë kualifikime teknike ose të kërkojnë që të aprovet akti i themelimit apo statuti, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, tarifatat dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

4. Dispozitat e lartpërmendura nuk mund të kërkojnë që kërkesa për autorizim të shqyrtohet në dritën e kritereve ekonomike të tregut.

Neni 9

Skema e operacioneve e përmendur në nenin 8 pika 1 shkronja "c" përfshin të dhëna ose prova: (a) për natyrën e risqeve që propozon të mbulojë ndërmarrja; kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policave që propozon të përdorë në të,

(b) për tarifatat që propozon të zbatojë për çdo kategori të veprimtarisë tregtare;

(c) për parimet orientuese në lidhje me risigurimin;

(d) për zërat në përbërje të fondit minimal të garancisë;

(e) për çmuarjet në lidhje me shpenzimet e vendosjes së shërbimeve administrative dhe organizimit për sigurimin e veprimtarisë tregtare; burimet financiare me të cilat synohen të mbulohen;

dhe, krahas këtyre, për tre vitet e para financiare: (f) për çmuarjet në lidhje me shpenzimet e administrimit me përjashtim të kostove të instalimit, sidomos në lidhje me shpenzimet e përgjithshme korente dhe komisionet;

(g) për çmuarjet në lidhje me primet ose kontributet dhe kërkesat për dëmshpërblim;

(h) për një parashikim të bilancit;

(i) për çmuarjet lidhur me burimet financiare me të cilat mendohet të mbulohen detyrimet e kontraktuara dhe niveli i aftësisë pague.

Megjithatë, të dhënat e përmendura në shkronjën "a" dhe "b", më lart, nuk kërkohen në lidhje me risqet e klasifikuara në nënpikat 4, 5, 6, 7 dhe 12 të pikës "A" të Shtojcës, po kështu as ato të përmendura në shkronjën "b", më lart, nuk kërkohen në lidhje me risqet e klasifikuara në nënpikat 14 dhe 15 të pikës "A" të Shtojcës. Të dhënat e përmendura në shkronjën "a" dhe "b" nuk është nevoja të kërkohen në rastin e risqeve të klasifikuara në nënpikën 11 të së njëjtës pikë.

Neni 10

1. Çdo Shtet Anëtar kërkon që ndërmarrja me zyrë qendrore në territorin e një Shteti Anëtar tjetër dhe që kërkon autorizim për të hapur një agjenci ose degë: (a) të dorëzojë statutin dhe listën e anëtarëve të këshillit të administrimit dhe administratorëve;

(b) të vërë në dispozicion një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit ku ndodhet zyra qendrore, ku vërtetohen klasat e sigurimeve për të cilat ndërmarrja ka të drejtë të ofrojë dhe se e zotëron fondin minimal të garancisë ose, nëse është më i lartë, nivelin minimal të aftësisë paguese të llogaritur në përputhje me nenin 16 pika 3, dhe ku të renditen risqet që faktikisht i mbulon ndërmarrja dhe burimet financiare të përmendura në nenin 11 pika 1 shkronja “e”;

(c) të paraqesë skemën e operacioneve në përputhje me nenin 11;

(d) të caktojë një agjent të autorizuar me vendqëndrim të përhershëm dhe banim në vendin pritës, i cili duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të vepruar në emër dhe për llogari të ndërmarrjes përpara të tretëve dhe për ta përfaqësuar në marrëdhëniet me autoritetet dhe gjykatat e vendit pritës; nëse agjenti ka personalitet juridik, duhet ta ketë zyrën qendrore në vendin pritës dhe duhet të caktojë një individ ta përfaqësojë i cili të përmbushë kushtet e lartpërmendura. Agjenti i caktuar nuk refuzohet nga Shteti Anëtar përveç se për shkaqe që kanë të bëjnë me reputacionin ose kualifikimet teknike si ato që zbatohen për anëtarët e këshillit të administrimit të ndërmarrjeve me zyra qendrore në territorin e Shtetit në fjalë.

Sa i takon subjektit “Lloyd's”, në rast padie në vendin pritës të ngritur në lidhje me angazhimet e kontraktuara, personat e siguruar nuk duhen trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se ç'do të ishin trajtuar sikur padia të ishte ngritur kundër subjekteve tregtare të një natyre konvencionale. Për rrjedhojë, agjenti i autorizuar duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për t'u paditur dhe, në këtë cilësi, duhet të jetë në gjendje të veprojë në emër dhe për llogari të siguresve në fjalë të anëtarësuar në "Lloyd's".

2. Çdo Shtet Anëtar kërkon që, me qëllim zgjerimin e veprimtarisë tregtare të agjencisë ose degës, qoftë për të mbuluar klasa të tjera ose pjesë të tjera të territorit kombëtar në rastin e parashikuar në nenin 6 pika 2 shkronja “d”, subjekti që kërkon autorizimin të dorëzojë skemën e operacioneve në përputhje me nenin 11 dhe të përmbushë kushtet e parashikuara në pikën 1 shkronja “b” më lart.

3. Këto masa bashkërenduese nuk i pengojnë Shtetet Anëtare të zbatojnë dispozita që kërkojnë, për të gjitha ndërmarrjet e sigurimeve, të aprovohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, tarifat dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

4. Dispozitat e lartpërmendura nuk mund të kërkojnë që kërkesa për autorizim të shqyrtohet në dritën e kritereve ekonomike të tregut.

Neni 11

1. Skema e operacioneve e agjencisë ose degës e përmendur në nenin 10 pika 1 shkronja "c" përfshin të dhëna ose prova: (a) për natyrën e risqeve që propozon të mbulojë ndërmarrja në vendin pritës; kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policave që propozon të përdorë në të,

(b) për tarifat që ndërmarrja propozon të zbatojë për çdo kategori të veprimtarisë tregtare;

(c) për parimet orientuese në lidhje me risigurimin;

(d) për gjendjen e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes të përmendur në nenin 16 dhe 17;

(e) për çmuarjet në lidhje me shpenzimet e vendosjes së shërbimeve administrative dhe organizimit për sigurimin e veprimtarisë tregtare; burimet financiare me të cilat synohen të mbulohen;

dhe, krahas këtyre, për tre vitet e para financiare: (f) për çmuarjet lidhur me shpenzimet e administrimit;

(g) për çmuarjet në lidhje me primet ose kontributet dhe kërkesat për dëmshpërblim për veprimtarinë e re tregtare;

(h) për një parashikim të bilancit për agjencisë ose degën.

Megjithatë, të dhënat e përmendura në shkronjën “a” dhe “b”, më lart, nuk kërkohen në lidhje me risqet e klasifikuara në nënpikat 4, 5, 6, 7 dhe 12 të pikës “A” të Shtojcës, po kështu as ato të përmendura në shkronjën “b”, më lart, nuk kërkohen në lidhje me risqet e klasifikuara në nënpikat 14 dhe 15 të pikës “A” të Shtojcës. Të dhënat e përmendura në shkronjën “a” dhe “b” nuk është nevoja të kërkohen në rastin e risqeve të klasifikuara në nënpikën 11 të së njëjtës pikë.

2. Skema e operacioneve shoqërohet me bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të ndërmarrjes për secilin prej tre viteve të fundit financiare. Megjithatë, nëse nuk ka ushtruar veprimtari tregtare për tre vite financiare, i kërkohet t’i vërë në dispozicion verem për vitet financiare të përfunduara.

Sa i takon shoqatës “Lloyd’s”, publikimi i bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve zëvendësohet me paraqitjen e detyrueshme të llogarive vjetore tregtare që mbulojnë operacionet e sigurimit dhe shoqërohen me një dëshmi që vërteton se janë vënë në dispozicion certifikatat e audituesve në lidhje me secilin sigurues dhe që tregojnë se përgjegjësitë e lindura si rrjedhojë e këtyre operacioneve janë të mbuluara tërësisht me aktive. Këto dokumente duhet t’u japin mundësi autoriteteve të krijojnë një pamje të gjendjes së aftësisë pagueuse të kësaj shoqate.

3. Skema e operacioneve, së bashku me vërejtjet e autoriteteve që kanë kompetencën për dhënien e autorizimit, u përcillet autoriteteve kompetente të vendit të zyrës qendrore. Këto të fundit ua komunikojnë opinionin e tyre autoriteteve që kanë kompetencën për dhënien e autorizimit, brenda tre muajve pas marrjes së dokumenteve; nëse opinionin e tyre nuk komunikohet pas përfundimit të këtij afati, konsiderohet se opinionin është pozitiv.

Neni 12

Çdo vendim për të refuzuar dhënien e autorizimit shoqërohet me arsyet e përpikta të këtij vendimi dhe i njoftohet ndërmarrjes në fjalë.

Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës në rast refuzimi.

Një parashikim i tillë bëhet edhe për ato raste kur autoritetet kompetente nuk i japin përgjigje kërkesës për autorizim brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së kërkesës.

Seksioni B : Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë tregtare

Neni 13

Shtetet Anëtare bashkëpunojnë nga afër me njëri tjetrin për mbikëqyrjen e pozicionit financiar të ndërmarrjeve të autorizuara.

Neni 14

Autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes duhet të verifikojë gjendjen e aftësisë pagueuse të ndërmarrjes në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare të saj. Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare të tjera i japin autoritetit të përmendur në fjalinë e mëparshme të gjitha informacionet e nevojshme për të mundësuar kryerjen e një verifikimi të tillë.

Neni 15

1. Çdo Shtet Anëtar në territorin të cilit ushtrohet veprimtaria tregtare i kërkon ndërmarrjes së krijojë rezerva teknike të mjaftueshme.

Niveli i rezervave të tilla përcaktohet në përputhje me rregullat e vendosura nga Shteti ose, në mungesë të rregullave të tilla, në përputhje me praktikrat e vendosura në këtë Shtet.

2. Rezervat teknike kërkohet të mbulohen me aktive të barasvlershme dhe përputhëse që ta kenë vendndodhjen në secilin vend ku ushtrohet veprimtaria tregtare. Por Shteti Anëtar i origjinës mund të lejojë lehtësime në rregullat për aktivet përputhëse dhe për vendndodhjen e aktiveve.

Duke mbajtur në konsideratë pozicionin e veçantë të tij, Dukati i Madh i Luksemburgut, në pritje të bashkërendimit të legjislacionit për mbylljen e veprimtarisë së ndërmarrjeve, mund ta mbajë në fuqi sistemin e garancive për rezervat teknike që ekziston në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.

Aktet normative të vendit ku ushtrohet veprimtaria tregtare përcakton natyrën e aktiveve të tilla dhe, sipas rastit, shkallën me të cilën mund të përdoren këto aktive për mbulimin e rezervave teknike dhe përcakton edhe rregullat për vlerësimin e aktiveve të tilla.

3. Shteti Anëtar që lejon mbulimin e rezervave teknike me pretendimeve kundrejt risiguruesve përcakton përqindjen e lejuar për këtë. Në këtë rast, ai nuk mund të kërkojë që aktivet që përfaqësojnë këto pretendime ta kenë vendndodhjen në territorin e tij, pavarësisht dispozitave të pikës 2.

4. Autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes verifikon nëse bilanci i saj tregon në lidhje me rezervat teknike aktive të barasvlershme me përgjegjësitë e kontraktuara të marra përsipër në të gjitha vendet ku ushtron veprimtari tregtare.

Neni 16

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh me zyra qendrore në territorin e tij të krijojë një nivel të mjaftueshëm të aftësisë pagueuse në lidhje me të gjithë veprimtarinë e saj tregtare.

Niveli i aftësisë paguese u korrespondon atyre aktiveve të ndërmarrjes të cilat nuk janë të zëna me asnjë pasiv të parashikueshëm, duke u zbritur zërat e aktiveve jomateriale. Në veçanti, merren në konsideratë zërat e mëposhtëm: - kapitali aksionar i paguar ose, në rastin e një koncerni kolektiv, fondi faktik fillestar,

- një e dyta e kapitalit aksionar të papaguar ose e fondit fillestar që nuk është paguar ende, pasi pjesa e paguar të ketë arritur 25 për qind të kapitalit aksionar ose të fondit,

- rezervat (rezervat ligjore dhe rezervat e lira) që nuk janë të lidhura me përgjegjësitë e kontraktuara,

- çdo fitim i mbartur,

- në rastin e fondeve kolektive apo të ngjashme me kontribute të ndryshueshme, çdo pretendim kundrejt anëtarëve në formën e kërkesës për kontribut shtesë, brenda vitit financiar, deri në një të dytën e diferencës midis kontributeve maksimale dhe kontributeve të kërkuara faktikisht dhe në varësi të një kufiri prej 50 për qind të nivelit,

- me paraqitjen e kërkesës ose të vërtetimit nga ndërmarrja dhe me miratimin e autoriteteve mbikëqyrëse të çdo Shteti Anëtar ku ushtron veprimtari tregtare ndërmarrja, çdo rezervë e fshehtë që del si rezultat i nënvlerësimit të aktiveve dhe mbivlerësimit të pasiveve, për aq sa këto rezerva të fshehta nuk janë të një natyre të jashtëzakonshme.

Mbivlerësimi i rezervave teknike konstatohet në lidhje me vlerën e tyre të llogaritur nga ndërmarrja në përputhje me aktet normative kombëtare; megjithatë, në pritje të bashkërendimit të mëtejshëm të rezervave teknike, një shumë e barasvlershme me 75% të diferencës midis shumës së rezervës për risqet e mbetura të llogaritura me një shkallë të sheshtë nga ndërmarrja duke zbatuar një përqindje minimale në lidhje me primet dhe shumës që do të kishte dalë nga llogaritja e rezervës kontratës pas kontrate kur legjislacioni kombëtar lejon mundësinë e zgjedhjes së njëres prej ty mënyrave, mund të merret në konsideratë në nivelin e aftësisë paguese deri në 20%.

2. Niveli i aftësisë paguese përcaktohet, ose në bazë të shumës vjetore të primeve ose kontributeve, ose në bazë të barrës mesatare të kërkesave për dëmshpërblim për tre vitet e fundit financiare. Megjithatë, nëse ndërmarrjet në thelb kontraktajnë përgjegjësi vetëm për një ose më shumë të risqeve të stuhisë, breshërit dhe ngricës, si periudhë bazë për barrën mesatare të kërkesave për dëmshpërblim merren shtatë vitet e fundit.

3. Në varësi të dispozitave të nenit 17, shuma e nivelit të aftësisë paguese është e barabartë me më të lartin e dy rezultateve të mëposhtme:

Rezultati i parë (baza e primeve): - mbliidhen bashkë primet ose kontributet (duke përfshirë pagesat që u shtohen primeve ose kontributeve) të arkëtueshme në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare gjatë vitit të fundit financiar për të gjitha vitet financiare,

- kësaj shume i mbledhim shumën e primeve të pranuar për të gjitha risigurimet gjatë vitit të fundit financiar,

- nga kjo shumë zbrësim shumë gjithsej të primeve ose kontributeve të anuluar gjatë vitit të fundit financiar si edhe shumë gjithsej të tatimeve dhe detyrimeve fiskale të lidhura me primet ose kontributet që janë përfshirë në shumë e mësipërme.

Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë ndahet në dy pjesë, e para deri në 10 milion njësi llogarie, e dyta përbëhet nga ajo që mbetet; përkatësisht, 18 për qind dhe 16 për qind e këtyre pjesëve llogariten dhe mbledhen bashkë.

Rezultati i parë gjendet duke shumëzuar shumë e llogaritur në këtë mënyrë me raportin ekzistues në lidhje me vitin e fundit financiar midis shumë së kërkesave për dëmshpërblim që mbeten të mbulohen nga ndërmarrja e sigurimeve pasi janë zbritur transferimet për risigurimin dhe shumë bruto të kërkesave për dëmshpërblim; ky raport në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 50 për qind.

Rezultati i dytë (baza e kërkesave për dëmshpërblim): - mbledhet shumë e kërkesave për dëmshpërblim të paguara në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare (pa zbritur kërkesat për dëmshpërblim të mbuluara nga risiguresit dhe retroceduesit) gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 2,

- kësaj shume i mbledhin shumë e kërkesave për dëmshpërblim të paguara në lidhje me risiguresit ose retroceduesit të pranuar gjatë së njëjtës periudhë,

- kësaj shume i mbledhim shumë e provigjoneve ose rezervave për kërkesat për dëmshpërblim që mbeten për t'u zgjidhur të krijuara në mbyllje të vitit të fundit financiar, si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare, ashtu edhe për pranimet në risigurim,

- nga kjo shumë zbrësim shumë e kërkesave për dëmshpërblim të paguara gjatë periudhave të përcaktuara në pikën 2,

- nga shuma e mbetur zbrësim shumë e provigjoneve ose rezervave për kërkesat për dëmshpërblim që mbeten për t'u zgjidhur të krijuara në çelje të vitit të dytë financiar që i paraprin vitit të fundit financiar për të cilin ka llogari, si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare, ashtu edhe për pranimet në risigurim.

Një e treta, ose një e shtata, e shumë së nxjerrë në këtë mënyrë, në përputhje me periudhën bazë të përmendur në pikën 2, ndahet në dy pjesë, e para deri në shtatë milion njësi llogarie, e dyta përbëhet nga ajo që mbetet; përkatësisht, 26 për qind dhe 23 për qind e këtyre pjesëve llogariten dhe mbledhen bashkë.

Rezultati i dytë gjendet duke shumëzuar shumë e llogaritur në këtë mënyrë me raportin ekzistues në lidhje me vitin e fundit financiar midis shumë së kërkesave për dëmshpërblim që mbeten të mbulohen nga veprimtaria tregtare pasi janë zbritur transferimet për risigurimin dhe shumë bruto të kërkesave për dëmshpërblim; ky raport në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 50 për qind.

4. Thyesat e zbatueshme për pjesët e përmendura në pikën 3 zvogëlohen secila në një të tretën në rastin e sigurimit të shëndetit të praktikuar mbi një bazë teknike të ngjashme me atë të sigurimit të jetës, nëse primet e paguara llogariten në bazë të tabelave të sëmundshmërisë në përputhje me metodën matematikore të zbatuar në sigurime,

- krijohet një rezervë për rritjen e moshës,
- mblihdhet një prim shtesë për të krijuar një nivel sigurie me vlerë të përshtatshme,
- siguruesi mund ta anulojë kontratën vetëm jo më vonë se përpara fundit të vitit të tretë financiar,
- kontrata parashikon mundësinë e rritjes së primeve ose zvogëlimit të pagesave, edhe për kontratat ekzistuese.

5. Në rastin e "Lloyd's", llogaritja e rezultatit të parë në lidhje me primet, e përmendur në pikën 3, bëhet në bazë të primeve neto, të cilat shumëzohen me një përqindje të sheshtë të fiksuar çdo vit nga audituesi i brendshëm. Kjo përqindje e sheshtë duhet të llogaritet në bazë të të dhënave më të fundit statistikore për komisionet e paguara.

Informacionet e hollësishme së bashku me llogaritjet përkatëse u dërgohen autoriteteve të vendeve ku është e vendosur shoqata "Lloyd's".

Neni 17

1. Një e treta e nivelit të aftësisë paguese përbën fondin e garancisë.
2. (a) Megjithatë, fondi i garancisë nuk mund të jetë më i vogël se:
 - 400 000 njësi llogarie në rastin kur mbulohen të gjitha ose disa prej risqeve të përfshira në njërin prej klasave të renditura në pikën "A" të Shtojcës në numrat 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15,
 - 300 000 njësi llogarie në rastin kur mbulohen të gjitha ose disa prej risqeve të përfshira në njërin prej klasave të renditura në pikën "A" të Shtojcës në numrat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe 16,
 - 200 000 njësi llogarie në rastin kur mbulohen të gjitha ose disa prej risqeve të përfshira në njërin prej klasave të renditura në pikën "A" të Shtojcës në numrat 9 dhe 17;
- (b) nëse veprimtaria tregtare që ushtron ndërmarrja mbulon disa klasa ose disa risqe, merret në konsideratë vetëm klasa ose risku për të cilin kërkohet shuma më e lartë;
- (c) Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë një zvogëlim me një të katërtat e fondit minimal të garancisë në rastin e fondeve kolektive dhe të fondeve të ngjashme me to.

Neni 18

1. Shtetet Anëtare nuk përcaktojnë asnjë rregull lidhur me zgjedhjen e aktiveve përtej atyre që përfaqësojnë rezervat teknike të përmendura në nenin 15.
2. Në varësi të dispozitave të nenit 15 pika 2, nenit 20 pika 1 dhe 3 dhe paragrafit të fundit të pikës 1 të nenit 22, Shtetet Anëtare nuk e kufizojnë disponimin e lirë të aktiveve, të luajtshme ose jo, që janë pjesë e aktiveve të veprimtarive tregtare të autorizuara.

Megjithatë, Republika Federale e Gjermanisë, në pritje të bashkërendimit të ardhshëm të kushteve për fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të jetës, mund të mbajë

në fuqi, në lidhje me sigurimin e shëndetit sipas kuptimit të nenit 16 pika 4, kufizimet e vendosura mbi disponimin e lirë të aktiveve për aq sa disponimi i lirë i aktiveve në mbulim të rezervave matematikore është objekt i marrëveshjes së një "Treuhänder".

Megjithatë Mbretëria e Danimarkës, gjer në marrjen e masave të mëtejshme të bashkërendimit, mund të mbajë në fuqi legjislacionin që e kufizon disponimin e lirë të aktiveve të krijuara nga ndërmarrjet e sigurimeve në mbulim të pensioneve të pagueshme në kuadër të sigurimit të detyrueshëm të aksidenteve industriale.

3. Këto dispozita nuk pengojnë marrjen e asnjë mase që Shtetet Anëtare, në respektim të rregullave në fuqi në vendin ku ushtrohet veprimtaria tregtare, siç e kërkon neni 15 pika 2, dhe në mbrojtje të interesave të personave të siguruar, kanë të drejtë të marrin si pronare, anëtare apo bashkëpunëtoresh të ndërmarrjeve në fjalë.

Neni 19

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje zyra qendrore e së cilës ndodhet në territorin e saj të vendosë në dispozicion një raport vjetor të situatës financiare dhe nivelit të aftësisë paguese, ku të mbulohen të gjitha llojet e operacioneve.

2. Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në territorin e tyre të paraqesin periodikisht deklarata, së bashku me dokumente statistikore, që janë të nevojshme në funksion të mbikëqyrjes. Autoritetet kompetente të mbikëqyrjes i japin njëri tjetrit dokumentet dhe informacionet e nevojshme për ushtrimin e mbikëqyrjes.

Neni 20

1. Nëse ndërmarrja nuk i përmbush dispozitat e nenit 15, autoriteti mbikëqyrës i vendit ku ushtron veprimtari tregtare mund ta ndalojë disponimin e lirë të aktiveve në atë vend pasi t'i ketë informuar për synimin e tij autoritetet mbikëqyrëse të vendit ku ndodhet zyra qendrore.

2. Në funksion të rimëkëmbjes së situatës financiare të ndërmarrjes niveli i aftësisë paguese të së cilës ka rënë poshtë minimumit që kërkon neni 16 pika 3, autoriteti mbikëqyrës i vendit të zyrës qendrore kërkon paraqitjen për miratim të një plani për rimëkëmbjen e një situate financiare të shëndoshë.

3. Nëse niveli i aftësisë paguese bie nën nivelin e fondit të garancisë të përcaktuar në nenin 17, autoriteti mbikëqyrës i vendit të zyrës qendrore i kërkon ndërmarrjes të paraqesë për aprovim prej tij një skemë financimi afatshkurtër.

Autoriteti në fjalë mund të kufizojë ose ndalojë edhe disponimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes. Autoriteti në fjalë informon për çdo masë autoritetet e Shteteve Anëtare të tjera në territorin e të cilave është autorizuar ndërmarrja dhe këto autoritete marrin të njëjtat masa me kërkesën e autoritetit të lartpërmendur.

4. Autoritetet mbikëqyrëse mund të marrin gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e personave të siguruar në rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 3.

5. Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare të tjera në territorin e të cilave është autorizuar ndërmarrja në fjalë bashkëpunojnë me qëllim vënien në zbatim të dispozitave të përmendura në pikat nga 1 deri në 4.

Neni 21

1. Çdo Shtet Anëtar ia bën të mundur ndërmarrjes të kalojë të gjithë ose një pjesë të portofolit të policave nëse personi pranues e zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese, pasi të jetë marrë në konsideratë edhe kalimi i portofolit.

Autoritetet mbikëqyrëse në fjalë konsultohen me njëri tjetrin përpara se ta miratojnë një kalim të tillë.

2. Pas miratimit nga autoriteti kompetent i mbikëqyrjes, një kalim i tillë i prek drejtpërdrejt policëmbajtësit ose personat e siguruar në fjalë.

Seksioni C : Heqja e autorizimit

Neni 22

1. Autorizimi i dhënë nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ndodhet zyra qendrore mund të hiqet po nga ky autoritet nëse ndërmarrja: (a) nuk i përmbush më kushtet e pranimit;

(b) nuk ka mundur, brenda afatit të lejuar, të marrë masat që përmban plani i rimëkëmbjes ose skema e financimit e përmendur në nenin 20;

(c) ka mospërmbushje serioze të detyrimeve që rrjedhin nga aktet normative kombëtare.

Në rast të heqjes së autorizimit, autoriteti mbikëqyrës i vendit të zyrës qendrore ua njofton heqjen e autorizimit autoriteteve mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare të tjera që i kanë dhënë autorizim ndërmarrjes; këto të fundit e heqin autorizimin e tyre pas kësaj. Autoriteti mbikëqyrës i vendit të zyrës qendrore, në bashkëpunim me këto autoritete të tjera, merr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e personave të siguruar dhe, sidomos, kufizon disponimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes nëse një kufizim i tillë nuk është vendosur më parë në përputhje me dispozitat e nenit 20 pika 1 dhe pika 3 paragrafi 2.

2. Autorizimi i dhënë një agjencie ose dege të ndërmarrjes zyra qendrore e së cilës ndodhet në një Shtet Anëtar tjetër mund të hiqet nëse agjencia ose dega: (a) nuk i përmbush më kushtet e pranimit;

(b) ka mospërmbushje serioze të detyrimeve që rrjedhin nga aktet normative të vendit ku ushtron veprimtari tregtare, në lidhje sidomos me krijimin e rezervave teknike siç përcaktohet në nenin 15.

Përpara heqjes së autorizimit autoritetet mbikëqyrëse të vendit ku ushrohet veprimtaria tregtare konsultohen me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku ndodhet zyra qendrore. Nëse e konsiderojnë të nevojshëm pezullimin e veprimtarisë tregtare të një agjencie ose dege të tillë përpara përfundimit të konsultimit, ato njoftojnë menjëherë autoritetin mbikëqyrës të vendit ku ndodhet zyra qendrore.

3. Çdo vendim për heqje autorizimi ose pezullim të veprimtarisë tregtare duhet të jetë i mbështetur me arsye precize dhe t'i njoftohet ndërmarrjes në fjalë.

Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës kundër një vendimi të tillë.

Titulli III - Rregullat e zbatueshme për agjencitë ose degët e vendosura brenda Komunitetit që u përkasin ndërmarrjeve me zyra qendrore jashtë Komunitetit

Neni 23

1. Çdo Shtet Anëtar ia nënshtron ushtrimin e veprimtarisë tregtare të përmendur në nenin 1 nga ana e ndërmarrjes me zyrë qendrore jashtë Komunitetit një autorizimi zyrtar.

2. Shteti Anëtar mund ta japë autorizimin nëse ndërmarrja përmbush të paktën këto kushte:

(a) ka të drejtë të ushtrojë veprimtaritë e sigurimeve në bazë të legjislacionit të vet kombëtar;

(b) vendos një agjenci ose një degë në territorin e Shtetit Anëtar;

(c) merr përsipër të krijojë në vendin e administrimit të agjencisë ose degës llogari të veçanta për veprimtarinë tregtare që ushtron në atë vend dhe të mbajë në atë vend të gjitha evidencat e lidhura me veprimtarinë tregtare të realizuar;

(d) cakton një agjent të autorizuar, për t'u miratuar nga autoritetet kompetente;

(e) zotëron në vendin ku ushtron veprimtari tregtare aktive me një shumë të barabartë në vlerë me të paktën një të dytën e shumës minimale të parashikuar në nenin 17 pika 2, në lidhje me fondin e garancisë, dhe depoziton një të katërtën e shumës minimale si garanci;

(f) merr përsipër të mbajë një nivel të aftësisë paguese në përputhje me kërkesat e përmendura në nenin 25;

(g) paraqet një skemë të operacioneve në përputhje me dispozitat e nenit 11 pika 1 dhe 2.

Neni 24

Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve të krijojnë rezerva teknike të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e kontraktuara në territorin e tyre. Shtetet Anëtare kujdesen që agjencia ose dega t'i mbulojë këto rezerva teknike me aktive ekuivalente me rezerva të tilla dhe aktive përputhëse, për aq sa përcaktohen nga Shteti në fjalë.

Për llogaritjen e rezervave teknike, përcaktimin e kategorive të investimeve dhe vlerësimin e aktiveve është i zbatueshëm legjislacioni i Shteteve Anëtare.

Shteti Anëtar në fjalë kërkon që aktivet që përfaqësojnë rezervat teknike ta kenë vendndodhjen në territorin e tij. Megjithatë është i zbatueshëm neni 15 pika 3.

Neni 25

1. Çdo Shtet Anëtar u kërkon agjencive ose degëve të vendosura në territorin e tij një nivel të aftësisë paguese të përbërë nga aktive të lira nga të gjitha detyrimet e parashikueshme, minus

zërat jomaterialë. Niveli i aftësisë paguese llogaritet në përputhje me dispozitat e nenit 16 pika 3. Por, për llogaritjen e këtij niveli, merren në konsideratë vetëm primet ose kontributet dhe kërkesat për dëmshpërblim që i përkasin veprimtarisë tregtare të realizuar nga agjencia ose dega në fjalë.

2. Një e treta e nivelit të aftësisë paguese përbën fondin e garancisë. Fondi i garancisë nuk mund të jetë më i vogël se një e dyta e minimumit të kërkuar në zbatim të nenit 17 pika 2. Depozita fillestare e bërë në përputhje me nenin 23 pika 2 shkronja "e" merret parasysh si pjesë e këtij fondi të garancisë.

3. Aktivitet që përfaqësojnë nivelin e aftësisë paguese duhen mbajtur brenda vendit ku ushtrohet veprimtaria tregtare deri në shumën e fondit të garancisë dhe pjesa tjetër duhen mbajtur brenda Komunitetit.

Neni 26

1. Çdo ndërmarrje që, pasi ka marrë autorizim nga një Shtet Anëtar, merr autorizim nga një ose më shumë Shtete Anëtare për të vendosur agjenci ose degë të tjera në to mund të paraqesë kërkesë për përfitimin e një ose më shumë prej avantazheve të mëposhtme: (a) që niveli i aftësisë paguese i përmendur në nenin 25 të llogaritet në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare që ushtron brenda Komunitetit; në një rast të tillë, merren në konsideratë vetëm primet ose kontributet dhe kërkesat për dëmshpërblim që i përkasin veprimtarisë tregtare të realizuar nga të gjitha agjencitë ose degët e vendosura brenda Komunitetit.

(b) që të përjashtohet nga kërkesa për të derdhur depozitën e kërkuar sipas nenit 23 pika 2 shkronja "e", edhe në këto Shtete të tilla;

(c) që aktivitet që përfaqësojnë fondin e garancisë të mbahen në cilindo Shtet Anëtar ku ushtron veprimtari tregtare.

2. Nëse të paktën dy prej Shteteve Anëtare në fjalë e miratojnë kërkesën tërësisht ose pjesërisht, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ndodhet vendosja më e vjetër e subjektit kërkuar verifikon gjendjen e aftësisë paguese të ndërmarrjes në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare që ushtron ajo brenda Shteteve Anëtare që e miratojnë kërkesën. Megjithatë, me kërkesë të ndërmarrjes dhe me miratimin unanimit të Shteteve Anëtare të prekura, një verifikim i tillë mund të bëhet nga autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar tjetër. Autoriteti që bën verifikimin merr nga Shtetet Anëtare të tjera informacionet e nevojshme në lidhje me agjencitë dhe degët e vendosura në territorin e tyre.

3. Avantazhet e dhëna me këtë nen hiqen me nismë të një ose më shumë të Shteteve Anëtare të prekura.

Neni 27

Dispozitat e neneve 19 dhe 20 zbatohen edhe në lidhje me agjencitë dhe degët e ndërmarrjeve për të cilat zbatohet ky Titull.

Sa i takon zbatimin të nenit 20, autoriteti mbikëqyrës i vendosjes më të vjetër ose autoriteti mbikëqyrës që bën në vendin e tij verifikimin e aftësisë së përgjithshme paguese të degëve

ose agjencive asimilohet nga autoriteti i Shtetit ku ndodhet zyra qendrore e një ndërmarrjeje të Komunitetit.

Neni 28

Në rastin e heqjes së autorizimit nga autoriteti i përmendur në nenin 26 pika 2, ky autoritet njofton autoritetet e Shteteve Anëtare të tjera ku ushtron veprimtari ndërmarrja dhe këto të fundit marrin masat e duhura. Nëse arsyeja e heqjes së autorizimit është pamjaftueshmëria e gjendjes së përgjithshme të aftësisë pagueuse sikurse përcaktohet nga Shtetet Anëtare të cilat kanë rënë dakord me kërkesën e përmendur në nenin 26, autorizimet i heqin edhe Shtetet Anëtare që kanë dhënë miratimin e tyre.

Neni 29

Komuniteti, përmes marrëveshjeve të lidhura në zbatim të Traktatit me një ose më shumë vende të treta, mund të miratojë zbatimin e dispozitave që janë të ndryshme prej atyre që parashikohen në këtë Titull, me qëllim sigurimin, në bazë reciprociteti, të mbrojtjes adekuate të personave të siguruar në Shtetet Anëtare.

Titulli IV – Dispozita kalimtare dhe të tjera

Neni 30

1. Shtetet Anëtare u lejojnë ndërmarrjeve të përmendura në Titullin II të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të masave zbatuese të kësaj Direktive ofrojnë sigurime në territorin e tyre në një ose më shumë prej klasave të përmendura në nenin 1 një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e njoftimit të kësaj Direktive, që të përmbushin kërkesat e nenit 16 dhe 17.

2. Gjithashtu, Shtetet Anëtare: (a) mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të përmendura në pikën 1, të cilat pas përfundimit të afatit pesëvjeçar nuk e kanë krijuar nivelin e aftësisë pagueuse, një afat shtesë jo më të gjatë se dy vjet për ta bërë një gjë të tillë me kusht që këto ndërmarrje, në përputhje me nenin 20, t'u kenë paraqitur për miratim autoriteteve mbikëqyrëse masat që propozojnë të marrin për këtë qëllim;

(b) mund t'i përjashtojnë ndërmarrjet e përmendura në pikën 1 të ardhurat e të cilave nga primet ose kontributet me përfundimin e periudhës pesëvjeçare janë më poshtë se një shumë që është gjashtë herë më e madhe se fondi minimal i garancisë që kërkon neni 17 pika 2 nga kërkesa për të krijuar një fond të tillë minimal garancie përpara fundit të vitit financiar në lidhje me të cilin të ardhurat nga primet ose kontributet janë sa gjashtëfishi i fondit minimal të garancisë. Pasi merr në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të parashikuar në nenin 33, Këshilli, me propozim të Komisionit, vendos unanimisht se kur duhet hequr ky përjashtim nga Shtetet Anëtare.

3. Ndërmarrjet që dëshirojnë t'i zgjerojnë operacionet e tyre sipas kuptimit të nenit 8 pika 2 ose sipas nenit 10 nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë nëse nuk përmbushin menjëherë rregullat e kësaj Direktive. Megjithatë, ndërmarrjet e përmendura në pikën 2 shkronja "b" të cilat brenda territorit kombëtar e zgjerojnë veprimtarinë tregtare në klasat e tjera të sigurimeve ose në pjesë të tjera të një territori të tillë mund të përjashtohen për një periudhë dhjetëvjeçare nga data e njoftimit të Direktivës nga kërkesa për të krijuar fondin minimal të garancisë të përmendur në nenin 17 pika 2.

4. Ndërmarrja që ka strukturë të ndryshme nga ato të renditura në nenin 8 mund të vijojë, për një periudhë trevjeçare duke filluar nga njoftimi i Direktivës, ta ushtrojë veprimtarinë ekzistuese tregtare në formën ligjore me të cilën është themeluar përpara momentit të një njoftimi të tillë. Ndërmarrjet e krijuara në Mbretërinë e Bashkuar me Urdhër Mbretëror ose me akt privat ose me akt publik të posaçëm mund ta vijojnë veprimtarinë e tyre tregtare me formën ekzistuese për një afat të pakufizuar.

Ndërmarrjet në Belgjikë të cilat, në përputhje me objektin e tyre, ushtrojnë veprimtarinë tregtare të kredive hipotekare ose të operacioneve të kursimeve në përputhje me numrin 4 të nenit 15 të dispozitave të lidhura me mbikëqyrjen e bankave private të kursimeve, të bashkërenduara nga akti "arrête royal" i datës 23 qershor 1967, mund të vijojnë ta ushtrojnë një veprimtari të tillë tregtare për një periudhë trevjeçare duke filluar nga data e njoftimit të kësaj Direktive.

Shtetet Anëtare në fjalë përpilojnë një listë të këtyre ndërmarrjeve dhe ua komunikojnë atë Shteteve të tjera Anëtare dhe Komisionit.

5. Me kërkesën e ndërmarrjeve që i përmbushin kërkesat e neneve 15, 16 dhe 17, Shtetet Anëtare pushojnë së zbatuari masa kufizuese si ato që kanë lidhje me barrën hipotekare, depozitat dhe garancitë e vendosura në kuadër të akteve normative ekzistuese.

Neni 31

Shtetet Anëtare u lejojnë agjencive ose degëve të përmendura në Titullin III të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të masave zbatuese të kësaj Direktive ndërmarrin një ose më shumë prej klasave të përmendura në nenin 1 dhe nuk e zgjerojnë veprimtarinë tregtare të tyre sipas nenit 10 pika 2 një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e njoftimit të kësaj Direktive, që të përmbushin kushtet e nenit 25.

Neni 32

Gjatë një periudhe që përfundon me hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje të lidhur me një vend të tretë në zbatim të nenit 29 dhe jo më vonë se përfundimi i një periudhe katërvjeçare pas njoftimit të Direktivës, çdo Shtet Anëtar mund të mbajë në fuqi në favor të ndërmarrjeve të atij vendi të vendosura në territorin e tij rregullat e zbatuara për to më 1 janar 1973 në lidhje me aktivet përputhëse dhe vendndodhjen e rezervave teknike, me kusht që të njoftohen Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisioni dhe që të mos kalohen kufijtë e lehtësimit të rregullave në zbatim të nenit 15 pika 2 në favor të ndërmarrjeve të Shteteve Anëtare të vendosura në territorin e tij.

Titulli V – Dispozita të fundit

Neni 33

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë nga afër me qëllim mundësimin e mbikëqyrjes së sigurimeve të drejtpërdrejta brenda Komunitetit dhe shqyrtimin e çdo vështirësie që mund të lindë në zbatimin e kësaj Direktive.

Neni 34

1. Komisioni i paraqet Këshillit, brenda gjashtë vjetësh nga data e njoftimit të kësaj Direktive, një raport për ndikimin e kërkesave financiare që vendos kjo Direktivë në situatën e tregjeve të sigurimeve të Shteteve Anëtare.

2. Komisioni i paraqet Këshillit raporte, sipas nevojës, përpara përfundimit të periudhës kalimtare të parashikuar në nenin 30 pika 1.

Neni 35

Shtetet Anëtare bëjnë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në dispozitat e tyre kombëtare për ta zbatuar këtë Direktivë brenda 18 muajve pas datës së njoftimit të saj dhe e informojnë për këtë Komisionin.

Dispozitat e ndryshuara në këtë mënyrë zbatohen, në varësi të neneve 30, 31 dhe 32, brenda 30 muajve pas datës së njoftimit.

Neni 36

Me të marrë njoftim për këtë Direktivë, Shtetet Anëtare sigurojnë që t'i komunikohen Komisionit tekstet e dispozitave kryesore me natyrë legjislative, rregullatore ose administrative që miratojnë në fushën që mbulon kjo Direktivë.

Neni 37

Shtojca është pjesë përbërëse e kësaj Direktive.

Neni 38

Kjo Direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Bërë në Bruksel, më 24 korrik 1973.

Për Këshillin

Presidenti

I. NØRGAARD

SHTOJCË

A. Klasifikimi i risqeve sipas klasave të sigurimeve 1. Aksidente (duke përfshirë dëmtimet dhe sëmundjet në punë) – pagesa të përcaktuara në mjete monetare

- pagesa në natyrën e dëmshpërblimit

- bashkim i të dyjave

- dëmtim i udhëtarëve

2. Sëmundjet – pagesa të përcaktuara në mjete monetare

- pagesa në natyrën e dëmshpërblimit

- bashkim i të dyjave

3. Automjetet tokësore (pa përfshirë inventarin e mjeteve lëvizëse mbi shina)

Të gjitha dëmet ose humbjet e – mjeteve motorike tokësore

- mjeteve tokësore pa përfshirë mjetet motorike

4. -mjetet e transportit hekurudhor

Të gjitha dëmet ose humbjet e mjeteve lëvizëse mbi shina

5. Mjetet ajrore

Të gjitha dëmet ose humbjet e mjeteve ajrore

6. Anijet (mjetet ujore detare, liqenore dhe lumore)

Të gjitha dëmet ose humbjet e – mjeteve lëvizëse lumore

- mjeteve lëvizëse liqenore

- mjeteve lëvizëse detare

7. Mallrat në transport (duke përfshirë mallrat tregtare, bagazhet dhe të gjitha mallrat e tjera)

Të gjitha dëmet ose humbjet e mallrave në transport ose bagazheve, pavarësisht formës së transportit

8. Zjarri dhe forcat e natyrës

Të gjitha dëmet ose humbjet e pronës (pa përfshirë pronën e përfshirë në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7) të shkaktuara nga - zjarri

- shpërthimet

- stuhitë

- forcat e natyrës pa përfshirë stuhinë

- energjia nukleare

- rënia e nivelit të tokës

9. Dëmtime të tjera në pronë

Të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (pa përfshirë ato që përfshihen në pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7) shkaktuar nga breshëri ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhja, pa përfshirë ato të përmendura në pikën 8

10. Përgjegjësia e mjeteve motorike

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i mjeteve motorike mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)

11. Përgjegjësia e mjeteve ajrore

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i mjeteve ajrore (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)

12. Përgjegjësia për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve)

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve, mjeteve lundruese ose barkave që lundrojnë në det, liqene, lumenj ose kanale (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)

13. Përgjegjësia e përgjithshme

Të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në pikat 10, 11 dhe 12

14. Krediti – paaftësia paguese (të përgjithshme)

- kreditimi i eksporteve
- kreditë e shlyera me këste
- kreditë hipotekare
- kreditë bujqësore

15. Garancitë - garancitë e drejtpërdrejta

- garancitë e tërthorta

16. Humbje të ndryshme financiare – risqet e punësimit

- pamjaftueshmëria e të ardhurave (e përgjithshme)
- moti i keq
- humbja e të ardhurave
- shpenzimet e përgjithshme të vazhduara
- shpenzimet tregtare të paparashikuara
- humbja e vlerës në treg

- humbja nga qiratë ose të ardhurat
- humbja e tërthortë nga tregtimi, pa përfshirë ato të përmendura më sipër
- humbjet e tjera financiare (jo nga tregtimi)
- forma të tjera të humbjeve financiare

17. Shpenzimet ligjore

Shpenzimet ligjore dhe kostot e proceseve gjyqësore

Risqet e përfshira në një klasë nuk mund të përfshihen në asnjë klasë tjetër përveç klasës së përmendur në pikën "C".

B. Përshkrimi i autorizimeve që jepen për më shumë se një klasë sigurimi

Kur autorizimi mbulon njëkohësisht: (a) Klasat nr. 1 dhe 2, ai emërtohet "Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit";

(b) Klasat nr.1 (nënpika e katërt), 3, 7 dhe 10, ai emërtohet "Sigurime motorike";

(c) Klasat nr.1 (nënpika e katërt) 4, 6, 7 dhe 12, ai emërtohet "Sigurimi i marinës dhe i transportit";

(d) Klasat nr. 1 (nënpika e katërt) 5, 7 dhe 11, ai emërtohet "Sigurimi i mjeteve ajrore".

(e) Klasat nr. 8 dhe 9, ai emërtohet "Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë";

(f) Klasat nr. 10, 11, 12 dhe 13, ai emërtohet "Sigurimi i përgjegjësive";

(g) Klasat nr. 14 dhe 15, ai emërtohet "Sigurimi i kreditit dhe i garancisë";

(h) Të gjitha klasat, ai emërtohet sipas zgjedhjes së Shtetit Anëtar në fjalë, i cili njofton Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin për emërtimin që ka zgjedhur.

C. Risqet shtesë

Ndërmarrja që merr autorizim për një risk parësor që i përket një klase ose një grupi klasash mund të sigurojë edhe risqe të përfshira në një klasë tjetër pa qenë nevoja për autorizim për këto të fundit nëse: - lidhen me riskun parësor,

- kanë të bëjnë me sendin e mbuluar lidhur me riskun parësor dhe

- përfshihen në kontratën me të cilën sigurohet risku parësor.

Megjithatë, risqet e përfshira në klasat 14 dhe 15 të pikës "A" të kësaj Shtojce nuk mund të konsiderohen risqe shtesë (ndihmëse) ndaj klasave të tjera

